

**INFORMACION PËR GJENDJEN ME RASTET ME PERTUSIS NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË  
SË VERIUT NË VITIN 2024, DERI MË 22.08.2024**

**Të dhëna javore**

Në periudhën 16-22.08.2024 në ISHP të RMV-së janë regjistruar gjithsej 10 raste të reja me pertusis, 52,4% më pak se javën që shkoi (n=20).

Numri më i madh i tyre (n=4; 40,0%) janë raportuar në Shkup, 2 në Kumanovë 6 dhe nga 1 rast në Dibër, Manastir, Kërçovë dhe Tetovë. (Tabela 1)

Mosha e të prekurve sillet nga 2 muaj deri në 43 vjet, ndërsa numri më i madh i përkasin grupmoshës nën 1 vjet (n=4; 40,0%).

Nga rastet e reja 2 (20%) raste janë hospitalizuar.

*Tabela 1. Shpërndarja gjeografike e rasteve me kollë të keqe në RMV, 16-22.08.2024*

<b>Qyteti/Komuna</b>	<b>numri i personave të sëmurë</b>
Shkup	4
Karposh	2
Gazi Babë	1
Saraj	1
Kumanovë	2
Manastir	1
Dibër	1
Kërçovë	1
Tetovë	1
Tearcë	1

**Të dhëna kumulative**

Në vitin 2024, deri me datë 22.08.2024, në ISHP të RMV-së janë regjistruar gjithsej 1032 raste me pertusis, me një incidencë prej 56,2/100,000 banorë.

Shpërndarja e rasteve sipas vendbanimit tregon se numri më i madh i të sëmurëve jetojnë në Shkup - 750 (72,7%) në shtatëmbëdhjetë komuna të ndryshme. (Tabela 2).

83 të sëmurë janë regjistruar në Kumanovë, Tetovë 59. ndërkohë që raste janë regjistruar edhe në 20 qytete të tjera.


*Tabela 2. Shpërndarja gjeografike e rasteve me kollë të keqe në RMV, (n=1032), 2024*

<b>Qyteti/Komuna</b>	<b>numri i personave të sëmurë</b>	<b>Qyteti/Komuna</b>	<b>numri i personave të sëmurë</b>
Shkup	750	Manastir	48

Aerodrom	156	Manastir	47
Karposh	121	Mogilla	1
Çair	85	Prilep	13
Kisella Voda	83	Dollnen	7
Qendër	67	Prilep	5
Gazi Baba	48	Krivogashtani	1
Gjorçe Petrov	41	Kratovë	12
Studenica	39	Gostivar	7
Butel	32	Gostivar	6
Saraj	23	Vrapçisht	1
Shuto Orizare	18	Kërçovë	7
Haraçina	13	Kriva Pallankë	6
Petrovec	9	Veles	4
Sopishte	5	Gjevgjeli	4
Çuçer Sandevë	4	Strumicë	3
Ilinden	4	Strumicë	2
Zelenikovë	2	Bosilovë	1
Kumanovë	98	Koçan	3
Kumanovë	83	Probishtip	3
Likovë	15	Dibër	3
Tetovë	59	Strugë	2
Tetovë	25	Krushevë	2
Zhelinë	14	Kavadar	2
Tearc	10	Prespë	2
Bogovinjë	4	Ohër	1
Brvenicë	4	Makedonski Brod	1
Jegunovc	2	Pllasnicë	1
		Demir Hisar	1
		Negotinë	1

Incidencë më e lartë prej 159,0/100.000 është regjistruar në Kratovë dhe në Shkup (123,6/100.000). (Hartogrami)

*Hartogrami. Incidenca në 100.000 banorë sipas QSHP/NJR, kolla e keqe në RMV, 2024*




Për sa i përket shpërndarjes sipas moshës, personat e prekur janë nga 1 muaj deri në 82 vjet (mesatarja 9,4 vjet). Numri më i madh i të sëmurëve janë deri në 4 vjet (33,3%), 207 ose 20,1% i përkasin grupmoshës nën 1 vjet, 137 (13,3%) janë nga 1 deri në 4 vjet.

Incidencë më e lartë është regjistruar tek grupmosha nën 1 vjet ( $I=1.251,9/100.000$ ). (Grafiku 1).

Shpërndarja sipas gjinisë tregon se 465 të sëmurë janë meshkuj, ndërsa 557 femra.


**Grafiku 1.** Shpërndarja e të sëmurëve me kollë të keqe ( $n=1032$ ) sipas moshës, në RMV, 2024



Lakorja epidemike tregon se shfaqja e rasteve të reja të kollës së keqe fillon në javën 50 të vitit 2023. Sipas të dhënave vërehet një rritje e vazhdueshme e numrit të rasteve në bazë

javore, deri në javën e 11. Nga java 12-17 numri i rasteve të regjistruara bie. Nga java 18-28 numri i rasteve të reja ka lëvizje të kohëpaskohëshme, ndërsa nga java e 29 vihet re një rënie e numrit të rasteve të raportuara.


**Grafiku 2.** Shpërndarja e të sëmurëve me kollë të keqe (n=1022) sipas javës së raportimit, në RMV, 2024



Sa i përket statusit të vaksinimit, 645 (62,5%) e pacientëve nuk kanë qenë të vaksinuar ose nuk i kanë pranuar të gjitha dozat sipas moshës dhe kalendarit të imunizimit, ose nuk ka të dhëna për statusin e vaksinimit. (Grafiku 3).

Të vaksinuar me të gjitha dozat në përputhje me moshën janë 387 persona. (Grafiku 3).

**Grafiku 3.** Statusi i vaksinimit dhe moshja e të sëmurëve (n=1032) me kollë të keqe në RMV



Nga të sëmurët në spital janë shtruar 151 persona (14,6%), ndërsa 130 (86,1%) prej tyre janë nën moshën 4 vjet. Numri më i madh i rasteve (101; 66,9%) janë shtruar në KU për sëmundjet e mushkërive tek fëmijët në Kozle. Nga numri i përgjithshëm i fëmijëve të shtruar në spital, 150 janë lëshuar si të shëruar. Të sëmurët kanë qëndruar në spital mesatarisht nga 9 ditë.

Nga numri i përgjithshëm (n=1032) i rasteve të regjistruara me kollë të keqe, 1030 janë konfirmuar laboratorikisht, përkatësisht në Avicena (265), Institutin e Shëndetit Publik (202), Biotek (171), QSHP Kumanovë (96), Sinlab (78), Instituti i mikrobiologjisë (40), SK Sistina (38), QSHP Manastir (31), Laor (48), Pllodnost Manastir (28), Klinikën Zhan Mitrev (18), SK Manastir (7), Remedika (4), dhe Ramus (4).

### Klasifikimi i rasteve:

Sipas Rregullores për kriteret për definimin e rasteve të sëmundjeve ngjitëse (Gazeta Zyrtare nr. 19/2018), nga numri i përgjithshëm i rasteve të raportuara (n=1032) të kollës së keqe, 1030 janë klasifikuar si raste të konfirmuara (të konfirmuara në laborator) dhe dy si të mundshme (ka një lidhje epidemiologjike me një rast të konfirmuar në laborator).

Hetimet epidemiologjike tregojnë një lidhshmëri mes 163 rastesh.

### Aktivitetet e realizuara për vaksinim me vaksinën e cila përmban komponentë të pertusis në Territorin e Qytetit të Shkupit dhe mbarë vendit

Në përputhje me rekomandimet e Komisionit të Sëmundjeve Infektive dhe të Institutit të Shëndetit Publik, në periudhën nga data 18.01.2024 e deri më tani, në të gjitha pikat e vaksinimit në vend, në bashkëpunim me shërbimet epidemiologjike të QShP-së, është bërë hetim intensiv i të personave të pa evidentuar, personave të pavaksinuar dhe atyre të pavaksinuar plotësisht, si dhe personave që i nënshtrohen vaksinimit të rregullt, në mënyrë që të thirren dhe të vaksinohen sipas Kalendarit kombëtar të imunizimit.


### **Shkup - numri i personave të vaksinuar në periudhën 18.01-22.08.2024**

Sipas të dhënave të siguruara nga ISHP Shtëpia e Shëndetit - Shkup, nga Shërbimi i Vaksinimit, është konstatuar se janë zbuluar 21.696 fëmijë që kanë lëshuar vaksinimin, dhe prej tyre janë vaksinuar 14.822 (68,3%). Nga të vaksinuarit, numri dhe përqindja më e madhe ka marrë rivaksinimin e parë (6.972; 47,0%).

Sipas moshës dhe Kalendarit të imunizimit të rregullt, janë vaksinuar 17.408 fëmijë nën moshën 7 vjeçare, ndërsa numri dhe përqindja më e madhe (11. 855; 68,1%) e fëmijëve të vaksinuar kanë marrë dozën II të revaksinimit në moshën shkollore.

Numri i përgjithshëm i dozave të vaksinës që përmban komponentë kundër pertusis, të dhëna si vaksinim primar (doza I, II, III) ose rivaksinim (rivaksinim I, II) në territorin e Shkupit në periudhën prej 18.01-22.08.2024 është 32.230.

*Grafiku 3. Numri i dozave të administruara në Shkup dhe në qytetet e tjera në RMV, 2024*




### Македонија е Veriut (pa Shkupin) - numri i personave të vaksinuar nga 18.01-22.08.2024

Nga të dhënat e deritanishme të dorëzuara nga Qendrat e Shëndetit Publik, 10.074 fëmijë kanë lëshuar vaksinimin, prej të cilëve 6.776 (66,9%) janë vaksinuar. Nga të vaksinuarit, numri dhe përqindja më e madhe ka marrë rivaksinimin e parë (3.070; 45,3%).

Sipas moshës dhe kalendarit të imunizimit të rregullt, janë vaksinuar 25.222 fëmijë nën moshën 7 vjeçare, ndërsa numri dhe përqindja më e madhe (15.038; 59,6%) e të vaksinuarve kanë marrë rivaksinimin II në moshën shkollore.

Numri i përgjithshëm i dozave të vaksinës që përmban komponentë kundër pertusis, të dhëna si vaksinim primar (doza I, II, III) ose rivaksinim (rivaksinim I, II) në periudhën nga 18.01-22.08.2024 është 31.998.

**Grafiku 3. Numri i dozave të administruara në Shkup dhe në qytetet e tjera në RMV, 2024**



### Rekomandime

Për ta parandaluar shfaqjen e rasteve të reja të kollës së keqe dhe për ta parandaluar përhapjen e mëtejshme të sëmundjes, është e nevojshme:

- Të rritet mbulimi me vaksinim primar me një vaksinë që përmban komponent kundër kollës së keqe që të mund të arrihet niveli i mbulimit të rekomanduar nga OBSH prej 95%, si në nivel rajonal ashtu edhe në atë lokal, si dhe në nivel kombëtar.
- Për këtë qëllim, në të gjitha pikat e vaksinimit në territorin e RMV-së, është e nevojshme të kryhet një inspektim i përforcuar dhe i vazhdueshëm i personave që i nënshtrohen vaksinimit të rregullt, si dhe të ftohen për aplikim të dozave të nevojshme të vaksinës. Gjithashtu, nevojitet një kërkim aktiv i intensifikuar i



personave të paevidentuar, të pavaksinuar dhe të pavaksinuar plotësisht, me qëllim që të ftohen për tu vaksinuar sipas Kalendarit kombëtar të imunizimit.

-Shërbimet epidemiologjike pranë QSHP/NJR në bashkëpunim me ISHSSH të kryejnë kontroll të intensifikuar në pikat e vaksinimit, kontrollin e statusit të vaksinimit të personave që i nënshtrohen vaksinimit të rregullt, gjetjen e personave të pavaksinuar dhe të pavaksinuar plotësisht.

-Të përfordhet mbikëqyrja epidemiologjike për kollën e keqe. Çdo rast i dyshuar që i plotëson kriteret klinike të definimit të rastit duhet të hetohet epidemiologjikisht, të testohet në laborator, pra të konfirmohet dhe të raportohet pranë institucioneve kompetente.

-Personat e dyshuar/të sëmurë të dërgohen për diagnostikim laboratorik dhe menjëherë të raportohen pranë institucioneve kompetente.

-Të bëhet izolimi i të sëmurëve në institucione shëndetësore ose në shtëpi, e sidomos nëse në familje ka foshnja, fëmijë të vegjël dhe persona të pavaksinuar, të paktën 5 ditë nga fillimi i terapisë me antibiotikë. E njëjta gjë vlen edhe për pacientët/kontaktet e dyshuara të personave të prekur nëse ata pranojnë kimioprofilaksë.

-Të gjithë mjekët amë duhet ta kontrollojnë statusin e vaksinimit të të gjithë fëmijëve deri në 14 vjet gjatë ekzaminimit dhe t'i udhëzojnë për vaksinim të gjithë fëmijët që e kanë lëshuar ndonjë dozë të vaksinës ose që janë të pavaksinuar;

-QSHP dhe ISHP të kryejnë aktivitete edukative dhe promovuese në lidhje me parandalimin e kollës së keqe, pra theksimin e vaksinimit si masën e vetme parandaluese për mbrojtjen e shëndetit të fëmijëve.

### **Vlerësimi i rrezikut:**

Kjo sëmundje në Republikën e Maqedonisë së Veriut është regjistruar me raste sporadike në 20 vitet e fundit (6 mesatarisht).

Rritja e numrit të fëmijëve të pavaksinuar (ulja e mbulimit me imunizimin e detyrueshëm), fushatat kundër vaksinimit, por edhe hezitimi i prindërve në lidhje me imunizimin shkaktojnë rishfaqjen e sëmundjeve të parandalueshme me vakcina në Maqedoni.

Duke marrë parasysh këtë, ekziston mundësia e regjistrimit edhe të rasteve të tjera të reja në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Ekziston një rrezik mesatar për popullatën në rajonet me mbulim të ulët me vaksinim, por ai mund të minimizohet duke i ndjekur rekomandimet e institucioneve kompetente.

### **Përfundime**

- Në vitin 2024 janë regjistruar 1032 të sëmurë me kollë të keqe.
- Numri më i madh i të sëmurëve është regjistruar në territorin e Shkupit (72,7%), ndërsa të sëmurë janë regjistruar në 22 qytete të tjera në RMV.
- Epidemi aktive ka në territorin e Shkupit, Tetovës dhe Kumanovës.

- Numri më i madh i pacientëve i përket grupmoshës 0-4 vjet (33,3%), incidenca më e lartë është regjistruar tek grupmosha nën 1 vjet dhe është 1.251,9/100.000 banorë.
- Nga numri i përgjithshëm i rasteve të regjistruara (1032), 641 raste (62,5%) nuk kanë qenë të vaksinuar, nuk kanë qenë të vaksinuar sipas moshës së tyre ose nuk ka të dhëna për vaksinimin.
- Nga fëmijët që janë vaksinuar plotësisht (n=282), koha mesatare e kaluar nga doza e fundit e vaksinës deri në shfaqjen e sëmundjes është 11 vjet.
- Nga 1032 rastet e raportuara, në laborator janë konfirmuar 1030 raste.
- Nga 18.01-22.08.2024, janë dhënë gjithsej 64.228 doza të vaksinës e cila përmban komponentë kundër kollës së keqe.

**Departamenti i epidemiologjisë së sëmundjeve infektive  
ISHPRMV**

**23.08.2024**